

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR

“KËRPI” SHPK

Sot më datën 18.08.2020 , unë ortaku i vetëm themelues i quajtur Florion KËRPI, i biri i Ilirjanit, i datëlindjes 14.10.1983, lindur në Tepelen, dhe banues në Fier, Adresa: Rruga: Brigada XI S, Kati II, mbi Bankën OTP,

Ne përputhje me Ligjin nr.9901 Date 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 date 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ka vendosur të themeloj *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar “KËRPI” Shpk*

Neni 1.

EMERTIMI I SHOQËRISË

Shoqëria do të quhet “KËRPI” SHPK.

Neni 2

SELIA E SHOQËRISË


Selia e shoqërisë është në adresën Lagjia Apollonia, Rruga: Brigada XI S, kati i II-të mbi Bankën OTP, Fier. Shoqëria mund të hapë filial të tjera në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISË SE SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë :

- Në fushën ndëtim, ndërtesa dhe infrastrukturë dhe atë imobiliare.
- Projektim, ndërtim dhe tregtim të mjeteve të ndryshme luendruese.
- Tregtim i materialeve të ndryshme ndërtimi



Neni 4

KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë “ **KËRPI**“ SHPK është 100 (njëqindë) lekë.
Ky kapital është i ndare në 1 pjesë, e cila me vlerë nominale 100 (njemije) leke.
Kontributi i ortakëve është i ndare si vijon:
Z. Florion KËRPI, zoteron 1 kuotë e barabartë me 100 % të vlerës së kapitalit.

Neni 5

KOHEZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe mbi 10 vjet.

Neni 6

ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Florion Kërpi**, i cili emrohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.
Një Administrator tjetër mund të emrohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut të vetëm, që përfaqëson njëqindpërqind të pjesëve të kapitalit themeltar. Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.
Administratori mund të kryej të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.
Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 7

VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM

Ortaku i vetëm i cili zotëron njëqind për qind të kuotave merr vendime të cilat janë të vlefshme sipas pikës 3 të nenit 81 të ligjit “Për shoqëritë Tregtare”.
Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve, janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 8

NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shperndahet perbehet nga fitimi i vitit financiar ,te cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur respektivisht humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

Neni 9

LIKUIDIMI

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj, operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregetar shqiptar.

Neni 10

MOSMARREVESHJET

Mosmarreveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundert, ortaku themelues do ti drejtohet Gjykates se Rrethit për zgjidhje.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“KËRPI” SHPK

ORTAKU I VETEM

FLORION KËRPI

